



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

Nr. 96 Prot.

Tiranë më 16 . 01 .2023

Lënda: Dërgohet Vendimi nr. 18, datë 16.01.2023 i KIZ të UT.

Drejtuar: Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultetet e UT-së

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës”, Kreu II, neni 7 si dhe shkresës nr. 40 Prot., datë 16.01.2023 së Komisionit të Zgjedhjeve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të UT-së, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të Universitetit të Tiranës, ka marrë Vendimin nr. 18, datë 16.01.2023 “Për plotësimin e 1 (një) vendi vakant për anëtar – përfaqësues i studentëve dhe vendit vakant për sekretar, në Komisionin e Zgjedhjeve të fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Ut-së, si dhe fillimin e procesit të vetëkadidimit për këto vende”.

Lutemi që Vendimi i mëposhtëm, të publikohet në mjediset e Fakultetit dhe në faqen tuaj zyrtare.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin tuaj,

KRYETARI

Dr. Edvin Lame





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

Nr.18, Datë 16/01/2023

“Për plotësimin e 1 (një) vendi vakant për anëtar - përfaqësues i studentëve dhe vendit vakant për sekretar, në Komisionin e Zgjedhjeve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të UT-së, si dhe fillimin e procesit të vetëkandidimit për këto vende”

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës”, Kreu II, neni 7; si dhe shkresës me nr. 40, Prot., datë 16.01.2023, të Komisionit të Zgjedhjeve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të UT-së:

VENDOSI:

1. Shpalljen e hapjes së procesit të vetëkandidimit për plotësimin e 1 (një) vendi vakant për anëtar përfaqësues i studentëve, në Komisionin e Zgjedhjeve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të UT-së dhe fillimin e procesit të vetëkandidimit për të.



2. Shpalljen e hapjes së procesit të vetëkandidimit për plotësimin e vendit vakant për sekretar, në Komisionin e Zgjedhjeve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të UT-së dhe fillimin e procesit të vetëkandidimit për të.
3. Regjistrimi i kandidatëve për këto vende, fillon në datën 16.01.2023 dhe përfundon në datën 20.01.2023, nga ora 08.00 – 15.00. Regjistrimi i kandidatëve kryhet pranë Sekretarisë Teknike të KIZ, pranë Rektoratit të UT-së, ose elektronikisht, në adresën kizut2021@unitir.edu.al, sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi.
4. Vendimi dërgohet për zbatim në Fakultetin të Gjuhëve të Huaja të UT-së.
5. Vendimi publikohet në të mjediset e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe në faqen e tij zyrtare.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

1. Edvin Lame (Kryetar)

2. Xhensila Kadi (Anëtare)

3. Alnida Koroshi -//-

4. Shaniko Allajbeu -//-

5. Arjan Tushaj -//-

6. Eljon Doçe -//-

7. Dhurata Saraçi -//-

